

SYLLABUS: Ligjet dhe Tatimet ne Biznes

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FAKULTETI EKONOMIK
Titulli i lëndës:	Ligjet dhe Tatimet në Biznes
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti I-rë, semestri II-të
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	4 ECTS
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Ass.Alban Elshani
Detajet kontaktuese:	Alban.elshani@uni-pr.edu

Përshkrimi i lëndës:	Programi mësimor i lëndës Ligjet dhe Tatimet në Biznes, njofton studentët me kërkesat themelore të ligjeve tatimore, dhe ligjeve tjera të cilat ndërlidhen drejtëpërdrejtë me bizneset, duke shpjeguar kontekstin dhe qëllimin si dhe duke iu referuar kërkesave themelore të ligjeve në Kosovë.
Qëllimet e lëndës:	Përmes kësaj lëndë, studentët do të zhvillojnë një kornizë për kuptimin dhe aplikimin e sistemit tatimor në Kosovë, aplikimin e ligjeve tatimore për llojet e ndryshme të bizneseve, dhe aplikimin e ligjeve tjera relevante të bizneseve.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Në përfundim të ciklit të ligjëratave nga kjo lëndë, studentët duhet të jenë të aftë: 1. Të shpjegojnë rëndësinë e ligjeve tatimore në funksionimin e bizneseve në Kosovë; 2. Të zbatojnë llojet e tatimeve (TAP, TAK dhe TVSH) të aplikueshme në Kosovë; 3. Të zbatojnë kërkesat e ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe ligjeve tjera relevante për biznese; 4. Të kuptojnë ndërlidhjen apo efektin e zbritjeve të lejuara dhe ndikimin në pasqyrat financiare të subjekteve të ndryshme. 5. Të përshkruajnë kërkesat e ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim në Kosovë.

Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej orë
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10

Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	4	4
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	2	3	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	3	6
Projektet, prezantimet, etj.	2	5	10
Totali			100

Metodologjia e mësimëdhënies:	Mësimdhënia do të zhvillohet përmes ligjëratisë, detyrave praktike, interpretimeve individuale e grupore, punimit të seminareve, vetëvlerësimeve periodike, etj. Ligjëratat do të realizohen duke i prezantuar materialet në formën audio-vizuale përmes teknologjisë elektronike me programet e Windows Office. Në aspektin teorik do të ofrohen njohuri të përgjithshme shkencore, bazuar në literaturën bashkëkohore. Pjesa praktike kryesisht do të realizohet përmes shembujve konkret nga literatura dhe nga njohuritë praktike në ndërmarrjet prodhuese private e publike dhe te organizatat jofitimprurëse. Përmes kësaj metodologjie synojmë krijimin e raporteve ndër-vepruese profesor–student si dhe ai student-student.
--------------------------------------	--

Metodat e vlerësimit:	Studentët duhet të jenë pjesëmarrës aktivë të procesit mësimor. Mësimi aktiv kërkon që studentët të reflektojnë mbi gjërat që diskutohen e jo të jenë pranues pasivë të informative që u jepen. Ata janë inkurajuar që të shtrojnë pyetje. Po ashtu do të organizohet edhe puna grupore, në mënyrë që studentët të diskutojnë çështjet relevante dhe të këmbejnë mendimet e tyre. Natyrisht, paraprakisht do të kërkohet leximi dhe thellimi në literature relevante të lëndës.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i studentëve konsiston në: • Pjesëmarrja në ligjëratat: 10 pikë • Punimi seminarik: 10 pikë • Testi I (kolokiumi): 40 pikë • Testi II (kolokiumi): 40 pikë

Literatura	
Literatura bazë:	• Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SCAAK), P4 – Ligjet dhe Tatimet në Kosovë, Prishtinë, 2017
Lieratura plotësuese:	• Ligjet tatimore të Republikës së Kosovës; • Ligjet tjera relevante të Republikës së Kosovës;

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Sistemi tatimor
Java e dytë:	Korniza rregullative ndërkombëtare e kontabilitetit
Java e tretë:	Procedurat dhe sistemi tatimore në Kosovë
Java e katërt:	Tatimi ne të ardhura të korporatave
Java e pestë:	Tatimi ne te ardhura personale
Java e gjashtë:	Tatimi mbi vlerën e shtuar
Java e shtatë:	Testi i parë (Kolokiumi I)
Java e tetë:	Tatimin e normës së akcizës në Kosovë
Java e nëntë:	Pensionet në Kosovë
Java e dhjetë:	Ligji mbi shoqëritë tregtare
Java e njëmbëdhjetë:	Ligji themelor i punës në Kosovë
Java e dymbëdhjetë:	Likuidimi dhe riorganizmi i personave juridik në falimen
Java e trembëdhjetë:	Ligji për pengun
Java e katërmëdhjetë:	Bordi për raportimin financiar
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi i dytë (Kolokiumi II)
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Vijimi i rregullt i ligjëratave dhe ushtrimeve është i obliguar për të gjithë studentët e rregullt. Të gjithë studentët janë të obliguar që t'i përfillin rregullat e mirësjelljes: mbajtja e qetësisë, ç`kyqja e telefonave celularë dhe hyrja në sallë me kohë.	